



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË

URDHËR


Nr. 18289, datë 08.05.2018

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE DHE NDJEKJEN E DISA  
PROÇEDURAVE MBI PËRFAQËSIMIN LIGJOR TË BASHKISË SË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1.1, shkronja "b", nenit 64, shkronja "a" dhe "gj" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Zotit Alban Dokushi, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit, i delegoj kompetencën për të nënshkruar në emër të Bashkisë së Tiranës ankime/rekurse pranë të gjitha shkallëve të gjyqimit, kërkesat për pezullim të ekzekutimit të vendimit të formës të prerë, ku Bashkia e Tiranës, njësitë administrative, si dhe çdo strukturë e saj janë palë në proçeset gjyqësore.
2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Bashkisë së Tiranës në proçeset gjyqësore kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen nga Drejtori Përgjithshëm Juridik, Aseteve dhe Licencimit, në emër të personit që do të përfaqësojë bashkinë.
3. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Bashkisë së Tiranës, kur thirret si palë në gjykim, në proçeset gjyqësore, në të cilat struktura/institucioni i varësisë ka lidhje me objektin e padisë, lëshohen në emër të personit që do të përfaqësojë bashkinë, nga Drejtori i Përgjithshëm Juridik, Aseteve dhe Licencimit.
4. Përfaqësimi për çdo proçes gjyqësor bëhet nga Drejtoria e Ankimeve, pranë Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit, juristët pranë njësiteve administrative si dhe specialistë të fushës për të cilën është ngritur kërkesë padia, nëpërmjet autorizimit të lëshuar sipas pikës 2 dhe 3 të këtij urdhri.
5. Përfaqësuesit e caktuar të ndjekin me korrektësi seancat gjyqësore, për sa i takon pjesëmarrjes së tyre, e veçanërisht kontributit provues, paraqitjes së kërkesave, prapësimeve, pretendimeve, ankimeve, rekurseve, si dhe dokumenteve të tjera, që do të ndihmonin mbrojtjen e përpiktë të interesave të Bashkisë së Tiranës.
6. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proçeset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.



7. Në përfundim të proçeseve gjyqësore, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda një afati 5-ditor nga shpallja/njoftimi i vendimit, të paraqitet informacion i detajuar, i shoqëruar me vendimet përkatëse në Bashkinë e Tiranës.


8. Ngarkohen të gjitha strukturat e Bashkisë së Tiranës, për të shkëmbyer çdo njoftim për ecurinë dhe ndjekjen e proçeseve gjyqësore, me Drejtorinë e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit.

9. Ngarkohen Drejtori i Përgjithshëm Juridik, Aseteve dhe Licencimit, administrata e Bashkisë së Tiranës, si edhe çdo strukture/institucion vartësie, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe njoftohet publikisht.

KRYETAR

**Erion VELIAJ**

A circular official stamp of the Municipality of Tirana is visible. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRIE" at the top, "BASHKIA E TIRANË" at the bottom, and a central emblem. A handwritten signature, "Erion VELIAJ", is written across the stamp. A large, loopy handwritten mark is also present over the signature and stamp.